

## **Vendim nr. 33, datë 28.01.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahimi, Anëtar

në datën 28.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (I) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **ILIR MUZHAQI**

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-181, datë 30.01.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi në datën 19.01.2020 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë me kërkesë për rishikimin e vendimit nr.12-2020-200/55, datë 30.01.2020 të po asaj gjykate, duke parashtruar si shkaqe papajtueshmërinë e fakteve që janë vënë në themel të atij vendimi

me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë, si edhe daljen ose zbulimin e provave të reja që tregojnë se vendimi është i gabuar.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 12-2020-1807(473), datë 14.12.2020, ka vendosur mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se shkaqet mbi të cilat bazohet ajo kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, shkeljen procedurale dhe mosrespektimin e ligjit, të cilat dalin tej rasteve të përcaktuara nga neni 450 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) për rishikimin e vendimit. Sipas asaj gjykate, për këto pretendime kërkuesi duhej të kishte paraqitur ankim në gjykatën e apelit, e cila ka tagrin për të vlerësuar bazueshmërinë në ligj dhe në prova të një vendimi të një gjykate më të ulët. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2021-453 (83), datë 11.03.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke e gjetur të bazuar në ligj arsyetimin e saj. Sipas asaj gjykate, shkaqet e paraqitura nga kërkuesi janë të tilla që duhet të kanalizohen përmes ankimit të zakonshëm dhe nuk hyjnë në kategorinë e shkaqeve të jashtëzakonshme të ankimit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-181, datë 30.01.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka vlerësuar se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas atij kolegji, gjykatat më të ulëta kanë bërë një analizë tërësore dhe objektive të provave të pretenduara si të reja në kërkesën për rishikim dhe i kanë çmuar në bazë të bindjes së tyre të formuar nga shqyrtimi në tërësi i rrethanave të çështjes, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke dhënë edhe arsyet ligjore për mospranimin e kërkesës së kërkuetit. Të dyja vendimet gjyqësore janë mjaftueshëm të arsyetuara, duke u dhënë përgjigje shteruese dhe të drejtë të gjitha pretendimeve të kërkuetit, të ringritura në rekurs. Sipas atij kolegji, shkaqet e ngritura në rekurs për pjesën e analizës së provave të reja janë atribut i gjykatave të faktit dhe dalin jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

5. Në datën 17.11.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

## II

### **Pretendimet e kërkuetit**

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

- 6.1. *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi edhe pse kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë në datën 02.06.2023 kërkesë për caktimin e një avokati nga ndihma juridike falas, Kolegji Penal e ka shqyrtuar rekursin e tij pa praninë e një mbrojtësi.
- 6.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi në përbërje të trupit gjykues në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë gjyqtari I.P., i cili ka qenë në kushte papajtueshmërie, pasi ka shqyrtuar me dhjetëra kërkesa të paraqitura nga kërkuesi. Ky gjyqtar, si kryesues i Kolegjit Penal, duhet të kishte parasysht se kur i pandehuri nuk ka një mbrojtës të zgjedhur prej tij, duhet t'i caktohet një mbrojtës kryesisht.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitetin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

9. Për sa më lart, Kolegji çmon se në rastin konkret të ndalet në analizën e legjitimitetit *ratione materiae*, kriter që ka të bëjë me natyrën dhe përmbajtjen e pretendimeve të

parashtruara në ankimin kushtetues individual, ku kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të paanshmërisë në gjykim. Për sa i përket së drejtës së mbrojtjes, kërkuesi ka pretenduar se edhe pse ka paraqitur në datën 02.06.2023, në zyrën e protokollit të Gjykatës së Lartë, kërkesë për caktimin e një mbrojtësi nga ndihma juridike dytësore falas, Kolegji Penal e ka shqyrtuar rekursin e tij pa praninë e një mbrojtësi.

10. Në jurisprudencën kushtetuese Gjykata ka evidentuar se e drejta e mbrojtjes duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se në datën 03.06.2021, nëpërmjet shërbimit postar, në Gjykatën e Apelit Durrës është depozituar rekursi i kërkuesit përmes të cilit ai ka kundërshtuar vendimin nr. 10-2021-453 (83), datë 11.03.2021 të gjykatës së apelit, që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 12-2020-1807(473), datë 14.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Me shkresën nr. 149, datë 03.06.2021, Gjykata e Apelit Durrës, mbështetur në nenin 434/a të KPP-së, i ka kërkuar kërkuesit plotësimin e të metave të rekursit, pasi ai nuk ishte nënshkruar nga një mbrojtës sikundër kërkohet nga neni 435/5 i KPP-së, si edhe pagesën e tarifës së pullës së taksës prej 200 lekësh, pasi në të kundërt rekursi do të mbetej pa veprime. Po sipas shkresës, rezulton se kërkuesi ka marrë dijeni në datën 10.06.2021 dhe në të rezulton shënimi i tij se *“rekursi është i rregullt për sa kohë atij nuk i janë bërë me dije të metat e rekursit”*. Në vijim rezulton se mbi rekursin e kërkuesit çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë më 03.06.2021.

12. Me kërkesën e datës 02.06.2023, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për caktimin e një mbrojtësi nga ndihma juridike dytësore falas, sipas nenit 49/a të KPP-së dhe ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, pasi nuk ka mundësi për të zgjedhur vetë një avokat. Gjatë shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se rekursi është paraqitur jo në formën e parashikuar në nenin 435/5 të KPP-së, për arsye se rekursi është nënshkruar vetëm nga kërkuesi dhe jo nga një mbrojtës, sikundër kërkohet nga kjo dispozitë. Pavarësisht këtij konstatimi, Kolegji Penal ka vijuar më tej me shqyrtimin e shkaqeve të rekursit, duke arritur në përfundimin se ato nuk bëjnë pjesë në ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, për rrjedhojë ka vendosur mospranimin e rekursit.

13. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se edhe pse kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për caktimin e një mbrojtësi nga ndihma juridike dytësore, sikundër e ka ngritur si shkak në ankimin kushtetues mungesën e caktimit të një mbrojtësi, ai nuk ka argumentuar se cili aspekt i së drejtës së mbrojtjes është cenuar për këtë shkak, pra nëse pretendimi i tij ka të bëjë me hartimin e rekursit dhe nënshkrimin apo me të drejtën për të qenë i përfaqësuar në Gjykatën e Lartë. Për më tepër, pavarësisht të metës të konstatuar në lidhje me anën formale të rekursit, shkaqet e parashtruara nga kërkuesi janë marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal, i cili, në përfundim, ka vlerësuar se ato nuk janë të tilla që të cenojnë vendimin e kundërshtuar. Në këto kushte, mungesa e nënshkrimit të rekursit nga një mbrojtës nuk ka përbërë shkakun përcaktues për të cilin Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e tij dhe kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar në lidhje me bazueshmërinë në ligj të atyre shkaqeve nga gjykatat më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk arritur të provojë në këndvështrimin kushtetues cenimin e së drejtës kushtetuese të mbrojtjes, ndërkohë që vetëm fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues për të vënë në dyshim procesin e zhvilluar në atë gjykatë. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

14. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, për shkak se në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ka marrë pjesë gjyqtari I.P., i cili ka shqyrtuar më parë dhjetëra kërkesa të paraqitura prej tij. Kolegji vëren se gjykimi kushtetues është i natyrës argumentuese, që do të thotë se u takon palëve të parashtrajnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre (*shih vendimet nr. 57, datë 25.07.2017; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 45, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, edhe pse kërkuesi ka barrën e provës në këtë drejtim, ai nuk ka paraqitur as argumente, as ndonjë akt provues ose të dhënë për të mbështetur pretendimin e tij, si më sipër. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të provojë se proceset gjyqësore në të cilat pretendohet prej tij se ka marrë pjesë më parë gjyqtari i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë kanë të bëjnë me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore, çka të ketë krijuar një dyshim të justifikuar se vendimi i dhënë prej tij në rastin konkret ka qenë produkt i një procesi të njëanshëm. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.